



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primiemo/Prodato Received/Deliverty	25.07.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jodrnica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlyerja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAMSHUK	5341/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.827/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.827/2023 të datës 09.06.2023 të parashtruar nga ankuesja *«kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike „kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.07.2023, njëzëri mori këtë:*

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.827/2023 e datës 09.06.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile *«utje vetëm ankuesja»* me datë 09.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.827/2023, për shkak të mos kthimit të përgjigjies (nxjerrjes së vendimit sipas kërkesës së datës 06.05.2023) lidhur me kompensimin për funksione shtesë, duke pretenduar se bazuar në nenin 38 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë si dhe nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcion Shtesë, ankuesja në cilësi të kryetares së Komisionit për shitjen e banesave sipas Vendimit me numër 14-022/04-162259/22 të datës 12.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, i takon e drejta e kompensimit për funksionet shtesë në shumën prej 30% të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ, e mbi këtë bazë e njëjta kërkon që ky kompensim të bëhet në mënyrë retroaktive nga dita e hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcion Shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *(me tej Këshilli)* bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave,



me datë 13.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese pranë Komunës së Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 26.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankese së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4640/2023 të datës 09.06.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për kërkesë apo ankese të datës 06.04.2023 me numër të protokollit 14-030/01-0072586/23; Vendimin me numër 14-030/01-72586/23 të datës 06.04.2023 lidhur me caktimin e Komisionit për Shitjen e Banesave nga Kryetari i Komunës së Prishtinës; Vendimin me numër 14-020104-162259/22 të datës 12.07.2022 për formimin e Komisionit për Shitjen e Banesave nga Kryetari i Komunës së Prishtinës; Procesverbalin e datës 10.03.2023 nga Komisioni për Shitjen e Banesave; Procesverbalin e datës 03.03.2023 nga Komisioni për Shitjen e Banesave; Procesverbalin e datës 13.03.2023 nga Komisioni për Shitjen e Banesave; Akt emërimit të ankueses me numër 01-nr.112-810 të datës 01.03.2017; Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 13.06.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankese të datës 26.06.2023 nga Komuna e Prishtinës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; Kërkesën për kompensim material të orëve shtesë 06.02.2023 me numër 14-120/06-27687/23 të datës 06.02.2023; Kartelën e nëpunëses-ankueses të datës 23.06.2023, Kërkesën e datës 21.06.2023 përmes e-mailit zyrtar nga KPMSHC për informata zyrtare drejtuar Komunës së Prishtinës, Përgjigje në kërkesë nga organi i punësimit sipas emailit të datës 24.07.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse:*

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja është e punësuar në Komunën e Prishtinës dhe se e njëjta sipas Aktit të emërimit me numër 01 nr.112-810 të datës 16.07.2019 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Pasurisë*, në Drejtorinë e Pronës.

Kryetari i Komunës së Prishtinës përmes Vendimit me numër 14-022/04-162259/22 të datës 12.07.2022, ka miratuar formimin e Komisionit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, ku si kryesuese e këtij komisioni është caktuar ankuesja.

Ankuesja në ankese e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se e njëjta më datë 06.04.2023 ka parashtruar kërkesë lidhur me kompensimin për funksione shtesë sipas Vendimit me Nr.14-020/004-162259/22 të datës 12.07.2022, ndërsa Këshilli bazuar në sqarimet dhe dëshmitë e dorëzuara nga organi i punësimit ka vërtetuar se ankuesja me datë 06.04.2023 ka përcjell vetëm dëshmitë referuar akteve lidhur me formimin e Komisionit për Shitjen e Banesave dhe procesverbalet e këtij komisioni, mirëpo e njëjta nuk ka bashkangjitur kërkesë për kompensim mbi bazën e së cilës ka parashtruar ankese në Këshill.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 24 paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: "3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankese drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil", si dhe nenit 124 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "1.Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ,

nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim", respektivisht, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke u bazuar në konstatimin si më sipër se ankuesja përkundër faktit që ankesën në Këshill e ka parashtruar për shkak të heshtjes përkatësisht mos veprimit të organit të punësimit lidhur me kërkesën e ankueses të datës 06.04.2023 për kompensim për funksione shtesë, e njëjta nuk ka dorëzuar një kërkesë të tillë përveç dokumenteve që kanë të bëjnë me komisionin gjegjës dhe procesverbalet nga takimet e këtij komisioni, kështu që në mungesë të kërkesës në fjalë, rrjedhë se nuk kemi mos veprim të organit të punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se nuk janë përmbushur kushtet për pranueshmërinë e ankesës siç përcaktohet me nenin 129 paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Për më tepër Kolegji mori në konsideratë edhe Qarkoren me numër protokolli 356 të datës 22.03.2023 të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me zbatimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë, ku në pikën 10 është paraparë se kërkesa për kompensim nga Kryesuesi i Komisionit/Bordit për të gjithë anëtarët, dërgohet te Zyrtari më i Lartë Administrativ (ZKA) që ka nxjerrë vendimin.

Andaj, bazuar në konstatimet si më lartë, Kolegji thekson faktin se ankuesja fillimisht duhet të parashtoj kërkesë te Kryetari i Komunës së Prishtinës si Zyrtari më i Lartë Administrativ për kompensim të funksioneve shtesë, e më pastaj, e njëjta mund të parashtoj ankesë kundër veprimit apo mosveprimit të organit të punësimit në raport me kërkesën për kompensim, kështu që në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.827/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Ardita Perçuku-Shyti
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetrait të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.